



REPUBLIKA E SHQIPËRISË  
UNIVERSITETI "ISMAIL QEMALI" VLORE  
BORDI I ADMINISTRIMIT

Nr. 2306 Prot. 13

Vlorë më, 14.10.2024

**VENDIM**  
Nr. 30, datë 14.10.2024

**PËR**

**PËR CAKTIMIN E MASËS SË PAGESËS PËR ANËTARËT E KOMISIONEVE PËR ZGJEDHJET E UNIVERSITETIT "ISMAIL QEMALI", VLORE**

Në mbështetje të nenit 49 të Ligjit Nr. 80/2015 "Për arsimin e lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë", nenit 6, 7 të Rregullores "Për organizimin e zgjedhjeve për autoritetet dhe organet drejtuese në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë", në mbledhjen e datës 14.10.2024 Bordi i Administrimit,

**VENDOSI:**

1. Të miratojë pagesën e Kryetarit të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ), në masën 125.000 (njëqind e njëzet e pesë mijë) lekë.
2. Të miratojë pagesën e anëtarëve të Komisionit Institucional Zgjedhor (KIZ), në masën 120.000 (njëqind e njëzet mijë) lekë.
3. Të miratojë pagesën e Kryetarit të Komisionit të Apelit (KA), në masën 95.000 (nëntëdhjetë e pesë mijë) lekë.
4. Të miratojë pagesën e anëtarëve të Komisionit të Apelit (KA), në masën 90.000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.
5. Të miratojë pagesën e Kryetarit të Komisionit në Fakultete (KZF) në masën 90.000 (nëntëdhjetë mijë) lekë.
6. Të miratojë pagesën e anëtarëve të Komisionit në Fakultete (KZF) në masën 85.000 (tetëdhjetë e pesë mijë) lekë.
7. Ngarkohet për zbatimin e këtij vendimi Administratori dhe Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse në Universitetin "Ismail Qemali", Vlorë.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë

**KRYETAR**

**SOTIR NIKOLLA**

